



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 17 janar 2019

Z. Nehat Idrizi, Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

LETËR REKOMANDIMI

Ankesa nr. 839/2018

kundër

Këshillit Gjyqësor të Kosovës

I nderuari z. Idrizi,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike, më 15 nëntor 2018, e ka pranuar ankesën e z. [redacted] parashtruar kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK), për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike.

Në bazë të informatave që ka Avokati i Popullit, z. [redacted], më 31 tetor 2018, nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar me kërkesë KGJK-së, për qasje në dokumentin publik, përkatësisht për qasje në dosjen e tij, si kandidat në procedurën e rekrutimit për gjyqtar. Më 1 nëntor 2018, nëpërmjet postës e ka dërguar edhe kopjen fizike të kërkesës së njëjtë.

Më 6 dhjetor 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit është takuar më drejtorin e Përgjithshëm të KGJK-së dhe me shefin e Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim, lidhur me veprimet që KGJK-ja i ka ndërmarrë përkitazi me kërkesën e ankuesit për qasje në dokumentin e kërkuar, në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Më 7 dhjetor 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit është njoftuar nëpërmjet postës elektronike me përgjigjen që KGJK-ja ia ka drejtuar ankuesit. Përmes kësaj përgjigjeje, KGJK-ja e ka refuzuar kërkesën e ankuesit për qasje në dokumente publike, duke iu referuar nenit 27 të Rregullores për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve (më tutje *Rregullorja*), ndërsa ankuesin e ka njoftuar për dokumentet që i ka dorëzuar me rastin e aplikimit në konkursin për rekrutim të gjyqtarëve, e që nuk është kërkesë e ankuesit në këtë rast. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit e ka analizuar rregulloren në fjalë dhe vëren se neni 27 [Ruajtja e provimit dhe dosjeve] përcakton:

“1. Provimi ruhet dhe arkivohet së bashku me dosjen e kandidatëve të cilët e kanë kaluar atë, në bazë të rregullave për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve zyrtare.

2. Dosjet e kandidatëve të cilët nuk e kanë kaluar provimin, u kthehen atyre pas regjistrimit të të dhënave relevante për ruajtje.

3. Qasja në dokumentet e ruajtura sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, **bëhet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.**"

Ndërsa neni 28 [Përgjegjësia për zbulimin e të dhënave] përcakton:

"Në rast se zbulohet çfarëdo e dhëne apo informate lidhur me procesin e rekrutimit dhe provimit, në mënyrë të paautorizuar, në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe këtë rregullore nga personat që administrojnë procesin, trajtohet si shkelje e rëndë e detyrave të punës dhe zbulim fshehtësisë zyrtare."

Ligji nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), në nenin 12, paragrafi 1 shprehimisht i përcakton situatat për refuzimin e së drejtës për qasje në dokumente; dhe në paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet mundësia kur, nëse vetëm një pjesë e dokumenteve të kërkuara përfshihen nga ndonjë prej përjashtimeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, pjesët e mbetura të dokumentit bëhen publike. Në rastet kur refuzohet kërkesa për qasje, institucioni publik, i cili e refuzon qasjen në dokumentin në tërësi apo pjesërisht, duhet të japë arsye për refuzimin dhe të nxjerrë aktvendim të arsyetuar me shkrim përkitazi me refuzimin.¹

Ndërsa Ligji nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), në nenin 22 e përcakton të drejtën e subjektit të të dhënave, të cilat përpunohen nga kontrolluesi i të dhënave, në rastin konkret KGJK-ja, respektivisht kërkuesi i dokumenti, bazuar në këtë dispozitë, ka të drejtë për qasje të plotë në të gjitha të dhënat personale të tij. Neni 23 i LMDhP-së i përcakton detyrat dhe obligimet e kontrolluesit, në rastin në fjalë KGJK-së, që për çfarëdo informacioni të kërkuar nga subjekti i të dhënave duhet t'i lejohet qasja e plotë.

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit rikujton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 41, paragrafi 1, përcakton të Drejtën për Qasje në Dokumente Publike, sipas të cilit: "*Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike*". Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen përcakton: "*Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë*".

Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1 të LQDP-së, sipas të cilit: "*Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike*".

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit konstaton se refuzimi i kërkesës së ankuesit për qasje në dosjen e tij si kandidat në procedurën e rekrutimit për gjyqtar, ia mohon ankuesit të drejtën për qasje në dokumente publike, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë dhe me Ligj.

Së këndejmi, me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte

në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 27 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i

Rekomandon

Këshillit Gjyqësor të Kosovës

- ***Ta trajtojë kërkesën e ankuesit dhe t'i përgjigjet në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe legjislacionin përkatës në fuqi.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Hilmi Jashari

Avokat i Populli

Kopje: Z. Shkëlzen Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm në KGJK

¹ Ligji nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike, neni 13 [Refuzimi i qasjes në dokumente zyrtare]